



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/M6 – 9 Prot.
Nr. Dok. 202502451/

Tiranë 27/11/2025

Lënda: Rekomandim lidhur me shkeljen e të drejtave të ligjshme të shtetases M. K. dhe marrjen e masave për nxjerrjen e përgjegjësive dhe personave përgjegjës për shkeljet e kryera dhe mospërsëritjen e tyre në vijim.

Drejtuar: Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Durrës

Durrës

Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit

Tiranë

Për dijeni: Kryetarit të Bashkisë Durrës

Durrës

Ministrit të Punëve të Brendshme

Tiranë

Të nderuar,

Në ankesën drejtuar Avokatit të Popullit, shtetasja M.K., ka shprehur shqetësimin në lidhje me mungesën e sistemimit të familjes së saj me strehim, pas prishjes së banesës së saj nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT), në Bashkinë Durrës.

Ankuesja shkruan se ka qenë banore e zonës së ish Kënetës, Njësia Administrative nr. 6, në Bashkinë Durrës. Megjithatë, për shkak të realizimit të projekteve publike për ngritjen e banesave në kuadër të procesit të rindërtimit, banesa e saj prej 56 m2 është shembur, ndërkohë që nga ana e Bashkisë Durrës, i është premtuar se do të sistemohej së bashku me familjen e saj në një banesë të re.

Pas kësaj, ankuesja shkruan se ka përfitur nga ana e Bashkisë Durrës, vetëm pagesën e 5 muajve qira (përgjatë vitit 2022), dhe që atëherë e deri më sot nuk ka përfitur më asnjë lloj trajtimi, edhe pse ka një familje të përbërë nga katër anëtarë.

Problemi më madhor në këtë çështje për të dhe familjen e saj është fakti se, pas kaq vitesh nga shembja e banesës nuk janë sistemuar ende me një banesë të përshtatshme.

Në këto rrethana, ankuesja ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, për sqarimin dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Shqyrtimin e kësaj ankese, Avokati i Popullit e ka ndarë në dy komponentë kryesorë, njëri lidhur me veprimtarinë e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (*IMT*), në Bashkinë Durrës dhe komponenti tjetër lidhur me çështje të thelbit të procedurës së ndjekur në kuadër të zbatimit të Aktit Normativ nr. 9/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nga ana e Bashkisë Durrës.

Në këtë kuadër, duhet theksuar se objekti i analizës në këtë rekomandim i referohet veprimtarisë së IMT-së në Bashkinë Durrës, në trajtimin e këtij rasti.

Në funksion të hetimit administrativ për trajtimin e kësaj çështjeje, me anë të shkresës sonë nr. K3/M6-2 prot., datë 19.03.2025, kemi kërkuar nga Bashkia Durrës, dërgimin e shpjegimeve të shoqëruara me kopjen e dokumentacionit përkatës zyrtar provues, lidhur me pyetjet si më poshtë vijon:

1. Mbi bazën e cilit vendim/akt administrativ është vendosur prishja e banesës së zj. M.K.?
2. A ka qenë kjo banesë në pronësinë e ligjshme të ankueses/(bashkëshortit të saj), apo ka qenë një ndërtim informal?
3. Nëse ka qenë një ndërtim informal, a ka qenë vetëdeklaruar për legalizim dhe në ç’fazë trajtimi nga drejtoria vendore përkatëse e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, rezultonte objekti në kohën e marrjes së vendimit për prishjen e tij?
4. Cila ka qenë koha e ndërhyrjes nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Durrës, për prishjen e kësaj banese?
5. Mbi ç’bazë është trajtuar familja e zj. M.K., me pagesën e qirasë për strehim për 5 muaj, gjatë vitit 2022? Pse nuk ka vazhduar ky trajtim edhe për periudhën në vazhdim?
6. Si është parashikuar të trajtohet me banesë familja e zj. M.K., dhe kur është parashikuar të përfundojë ky proces?
7. Nëse banesa ka qenë pronë e ligjshme e ankueses/(bashkëshortit të saj), a janë zhvilluar procedura shpronësimi? Nëse po, a kanë përfunduar ato? Nëse jo, në cilën fazë ndodhen sot këto procedura?

Për shkak të mungesës së përgjigjes së pritshme nga Bashkia Durrës, jemi detyruar të përsërisim këtë kërkesë për shpjegime, me shkresën tonë nr. K3/M6-5 prot., datë 16.04.2025.

Paralelisht, me shkresën tonë nr. K3/M6-3 prot., datë 19.03.2025, kemi kërkuar nga ana e IMT-së në Bashkinë Durrës, dërgimin e shpjegimeve të detajuara të shoqëruara me kopjen e dokumentacionit përkatës zyrtar provues, lidhur me pyetjet si më poshtë vijon:

1. Mbi bazën e cilit vendim/akt administrativ është vendosur prishja e banesës së zj. Kulicaj?
2. A ka qenë kjo banesë në pronësinë e ligjshme të ankueses/(bashkëshortit të saj), apo ka qenë një ndërtim informal?
3. Nëse ka qenë një ndërtim informal, a ka qenë vetëdeklaruar për legalizim dhe në ç'fazë trajtimi nga drejtoria vendore përkatëse e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, rezultonte objekti në kohën e marrjes së vendimit për prishjen e tij?
4. Cila ka qenë koha e ndërhyrjes nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Durrës, për prishjen e kësaj banese? (Lutemi bashkëngjisni specifikisht, një kopje të të gjithë praktikës dokumentare administrative të nxjerrë nga ana juaj si organ publik, për prishjen e këtij objekti).

Për shkak të mungesës së përgjigjes së pritshme nga ana juaj, jemi detyruar të përsërisim këtë kërkesë për shpjegime me shkresën tonë nr. K3/M6-5 prot., datë 16.04.2025.

Në datë 03.06.2025 (shkresa nr. 6641 prot.), Bashkia Durrës, ka sjellë një përgjigje të plotë në të cilën na jepet informacioni, ndër të tjera, se kjo familje shtëpia e së cilës është prishur për shkak të kryerjes së një investimi publik, në zonën e ish-Kënetës, Njësia Administrative nr. 6, në Bashkinë Durrës, është trajtuar me bonus qiraje në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 49, datë 14.04.2021, *“Për miratimin e listës së familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë të mbetura të pastreha si pasojë e shembjes së banesave të tyre në zbatim të projektit të Rindërtimit – Sheshi Dysh, Zona 4, Durrës – Spitallë”*.

Nga ana e kësaj njësie të vetëqeverisjes vendore konfirmohet se për periudhën në vazhdim do të ndiqet procedura e miratimit në Këshillin Bashkiak Durrës, të fondeve përkatëse. Ndërkohë, sjellim në vëmendje faktin se familja e zj. Kuliçaj, ka muaj të tërë pa u trajtuar me bonus qiraje.

Në vijim, në përgjigjen e dhënë nga ana e IMT-së në Bashkinë Durrës, me shkresën nr. 575/2 prot., datë 02.05.2025, na është dhënë informacioni se në zbatim të legjislacionit në fuqi i është bërë njoftim për prishjen e objektit zj. M.K., bazuar në shkresën nr. 2316 prot., datë 13.04.2022, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), *“Njoftim mbi vendimmarrjen në lidhje me skualifikimin e bërë nga procesi i legalizimit të objekteve të pozicionuara në zonën kadastrale z.k. 8517, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 164, datë 19.02.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në njësinë administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”*, si dhe të ligjit nr. 111/2018 *“Për kadastrën”*.

Në ushtrim të përgjegjësi nga ana e IMT-së në Bashkinë Durrës, në përgjigje thuhet se është nxjerrë Urdhri i kryeinspektorit të IMT-së në Bashkinë Durrës, nr. 23, datë 13.09.2022 *“Për prishje të objekteve të skualifikuara nga legalizimi ZK 8517, Durrës”*, ku i është kërkuar mbështetje organeve ligjzbatuese, përkatësisht Komisarariatit të Policisë së Shtetit, Durrës, dhe Policisë Bashkiake Durrës, si dhe Njesisë Administrative nr. 4 dhe Njesisë Administrative nr. 6, Bashkia Durrës.

Nga ana e IMT-së në Bashkinë Durrës, thuhet në vijim, është mbajtur procesverbal ekzekutimi nr. 1813/6 prot., datë 02.11.2022, për prishjen e objektit të zj. M.K., të ndodhur në lagjen nr. 14/1, rruga *“Vala e detit”*, ish-Kënetë, z.k. 8517, Bashkia Durrës.

Bashkëngjitur kësaj shkrese janë dërguar kopje të këtyre shkresave zyrtare, që lidhen me trajtimin e kësaj çështjeje:

1. Shkresa nr. 1814 prot., datë 13.09.2022, “Njoftim për prishje objekti”, e IMT-së në Bashkinë Durrës, drejtuar zj. M.K., si dhe për dijeni, Njesisë Administrative nr. 4 dhe Njesisë Administrative nr. 6, Bashkia Durrës.
2. Procesverbal ekzekutimi i IMT-së në Bashkinë Durrës, nr. 1813/6 prot., datë 02.11.2022, i nënshkruar nga inspektorë të IMT-së në Bashkinë Durrës, si dhe përfaqësues të Policisë Bashkiake Durrës.
3. Disa foto të marra gjatë momentit të prishjes së objektit të disponuar nga zj. M.K..

Në analizë të legjislacionit në fuqi, për trajtimin e kësaj çështjeje nga ana e organit tuaj publik, evidentojmë:

1. Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar (ligji nr. 9780/2007)¹. Referuar kohës në të cilën është trajtuar kjo çështje evidentojmë se kanë qenë në fuqi këto parashikime ligjore:

- “Kontrolli i Territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga,
a) Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore përkatëse” (neni 3, paragrafi “a”).
- “Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:
a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit;
ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;
dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;
e) detyrohet t’i japë informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit brenda një afati kalendarik 5-ditor nga data marrjes së kërkesës, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij inspektorati;

¹ Referenca në parashikimet e ligjit nr. 9780/2007, bëhet duke marrë parasysh ndryshimet që ai ka pësuar deri në kohën kur edhe ka ndodhur ndërhyrja nga ana e IMT-së në Bashkinë Durrës, pra deri në datën 13.09.2022.

e) merr vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme;
f) përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të këtij neni.” (neni 5).

- Në përputhje me parashikimin e pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9780/2007, inspektoriati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore përkatëse, ka detyrimin që për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, të kryejë inspektime me një grup inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se tre inspektorë, ose me një grup inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe një inspektor të njësisë vendore.

Në pikën 5, të nenit 12, të ligjit nr. 9780/2007, parashikohej se:

“Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit, i cili ngarkohet në sistemin elektronik dhe nënshkruhet si nga inspektorët që kryejnë kontrollin, ashtu edhe nga subjekti i kontrolluar, ose nga përfaqësuesi i tij, kur ky është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i përcillet elektronikisht subjektit të kontrolluar”.

Në shkronjën “c”, të pikës 8, të po këtij neni parashikohej se:

“Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore, për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në ligj, kanë të drejtë:

- b) Të përfshijnë në kontrollin e tij prishjen e një ndërtimi ekzistues, ndërtimin apo punimet për ndërtimin e një objekti të ri, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore e nëntokësore, si dhe punimet/ndërtimet, që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve”.*

- Në vijim, në paragrafin e parë dhe të fundit të nenit 13, të ligjit nr. 9780/2007, parashikohej se:

“Brenda 10 ditëve nga mbajtja e procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore marrin vendimin për shkeljen e konstatuar brenda afatit të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni”.

2. Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ku parashikohet se:

- “1. “Akti administrativ”:

- a) “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë

subjektesh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete (neni 3, pika 1, shkronja “a”).

- “1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon me një vendimmarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrativ apo një kontratë administrative. Në vendimin përfundimtar për çështjen, organi publik vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij.
2. Përfundimi i procedurës administrative, të nisur kryesisht, është në diskrecion të organit publik, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji” (neni 90, pikat 1 dhe 2).
- “1. Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve” (neni 104, pika 1).
- “1. Organi publik i komunikon palës, ose një subjekti tjetër, të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural me anë të njoftimit.
3. Në çdo rast, organi publik kryen njoftimin, duke pasur parasysh efektivitetin e tij, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën dhe koston” (neni 147, pika 1 dhe pika 3).

3. Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“1. Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësisë, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar.

4. Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.

5. Të dhënat e përmbledhura dhe konkluzionet e veprimtarisë së inspektimit janë pjesë e raportit vjetor për zhvillimet në territor” (neni 51).

“6. Vendimi për prishjen e ndërtimeve përmban edhe detyrimin e prishjes së menjëhershme të ndërtimit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit” (neni 52, pika 6).

“7. Procedurat e konstatimit të kundërvajtjes, të njoftimit të kundërvajtësit, vendimit, ankimit dhe masave të tjera administrative, kundrejt shkeljeve të këtij ligji, si dhe ekzekutimi i dënimit rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi që rregullojnë inspektimin e ndërtimit” (neni 53, pika 7).

4. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore” (VKM nr. 894/2015), në pikat 7 dhe 18 të të cilit, parashikohet respektivisht se:

“7. Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit, si dhe në të gjitha rastet kur nuk respektohet vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim, nuk plotësohet dokumentacioni, teknik e ligjor dhe kur ka parregullsi në zbatimin e punimeve në objekt, brenda afatit kohor të parashikuar në vendimin përkatës. Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë dhe për kundërvajtësin përgatitet kallëzimi penal, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm mbahet sipas formës së parashikuar në aneksin shoqëruar të vendimit.

18. Formularët bashkëlidhur janë pjesë përbërëse e këtij vendimi me emërtesat përkatëse, si më poshtë vijon:

- a) Procesverbal për konstatimin e kundërvajtjes;*
- b) Vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm;*
- c) Vendim për pezullimin e punimeve;*
- ç) Vendim për dënim me gjobë;*
- d) Procesverbal për konstatimin e shpenzimeve të prishjes;*
- dh) Vendim për zhdëmtimin e shpenzimeve të prishjes dhe kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme;*
- e) Procesverbal për konstatimin e kundërvajtjes në fushën e mbikëqyrjes së IMT-së dhe planifikimit;*
- ë) Vendim për dënim me gjobë në fushën e mbikëqyrjes së IMT-së dhe planifikimit;*
- f) Procesverbal për sekuestrimin e mjeteve/ pajisjeve/materialeve;*
- g) Vendim për sekuestrimin e mjeteve/ pajisjeve/materialeve”.*

Nga këto parashikime ligjore del e qartë se IMT-ja në Bashkinë Durrës, me kërkesë të palëve të interesuara, apo me iniciativë, në ushtrim të kompetencave ligjore është i detyruar të kryejë procedura administrative rast pas rasti, në përputhje me kërkesat procedurale të legjislacionit në fuqi. Gjatë kryerjes së procedurës administrative, ky organ publik është i detyruar, në varësi të specifikës së çështjes, të nxjerrë aktet përkatëse administrative me natyrë konstatuese, apo edhe me natyrë ndëshkuese, sikundër edhe vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm. Këto akte administrative, (në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi të kohës kur është kryer prishja e objektit të zj. Mirjana Sef Kulicaj), duhej të nxirreshin në përputhje me formatin dhe përmbajtjen e formularit të miratuar për këtë qëllim, me VKM-në nr. 894/2015.

Sikundër rezulton nga shkresa juaj nr. 575/2 prot., datë 02.05.2025, iniciues i procedurës administrative në këtë çështje ka qenë një organ tjetër publik, ASHK-ja, me dërgimin e shkresës nr. 2316 prot., datë 13.04.2022, *“Njoftim mbi vendimmarrjen në lidhje me skualifikimin e bërë nga procesi i legalizimit të objekteve të pozicionuara në zonën kadastrale z.k. 8517, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 164, datë*

19.02.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në njësinë administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”. Pra, njoftimi i vendimmarrjes përkatëse të një organi tjetër publik, përkatësisht ASHK-së, për përfundimin e një procedure administrative të filluar mbi bazën e vetëdeklarimit nga subjektet e interesuara për legalizimin e ndërtimit pa leje, ka shërbyer si fakt juridik iniciues i procedurës tjetër administrative, e cila duhej të zhvillohej në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, nga ana e organit tuaj publik. Në këtë kuptim duhet theksuar se vendimmarrja e ASHK-së, lidhur me përjashtimin nga legalizimi të ndërtimit pa leje të vetëdeklaruar nga zj. M.K., është një vendimarrje që nuk mund të zëvendësojë në asnjë rrethanë kryerjen e procedurës administrative nominale dhe nxjerrjen e akteve administrative të nevojshme nga ana e organit tuaj publik, për konstatimin paraprakisht të ndërtimit të kundërligjshëm, sanksionimin me prishje dhe më pas prishjen e tij.

Në trajtimin e kësaj çështjeje duke iu referuar dhe marrë për bazë shpjegimet dhe kopjen e dokumentacionit zyrtar të dërguar nga IMT-ja në Bashkinë Durrës, konstatojmë se me shkresën nr. 1814 prot., datë 13.09.2022, ky organ publik ka njoftuar zj. M.K., për prishjen e objektit të disponuar prej saj. Më konkretisht, në përmbajtjen e këtij akti zyrtar, thuhet, ndër të tjera, se: “Në ushtrim të përgjegjësisë dhe në mbështetje të ligjit nr. 9870, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar, ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, për të bërë të mundur krijimin e kushteve për realizimin e punimeve brenda afateve ligjore të përcaktuara, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Durrës, ju njofton se në bashkëpunim me institucionet e tjera do të ndërhyhet për prishjen e objektit, duke filluar nga data 13.09.2022, e në vijim”. Në këtë rast evidentohet se nuk ka asnjë referencë në lidhje me të drejtat e ligjshme të ankueses, që cenohen nga veprimtaria e IMT-së në Bashkinë Durrës.

IMT-ja në Bashkinë Durrës, më konkretisht kryeinspektori i këtij organi publik, në ushtrim të kompetencave ligjore ka nxjerrë Urdhrin nr. 1813/3 prot., datë 13.09.2022 “Për prishjen e objekteve të skualifikuara nga legalizimi, zona kadastrale 8517, Durrës”.

Në përmbajtjen e këtij akti administrativ konstatojmë se pavarësisht emërtesës së tij, “Për prishjen e objekteve të skualifikuara nga legalizimi, zona kadastrale 8517, Durrës”, ka një mospërputhje mes kësaj emërtese (qëllimit në dukje të shprehur në të) dhe dispozitivit të aktit administrativ, në pikën 1, të të cilit urdhërohet ngritja e grupit përkatës të punës për prishjen e objekteve të skualifikuara nga procesi i legalizimit, të ndodhura në zonën kadastrale 8517, Durrës. Për më tepër, pika 3, e dispozitivit të këtij akti administrativ e bën atë të detyrueshëm për zbatim në datën 13.09.2022, ora 10.00”, e në vijim, ndërkohë që, në pikën 4, të po këtij dispozitivi bashkëngjitet lista e objekteve që do të prishen.

Po ashtu, në kopjen e dokumentacionit zyrtar të dërguar nga ana juaj ndodhet edhe një kopje e dokumentit “Procesverbal ekzekutimi”, nr. 1813/6 prot., datë 02.11.2022.

Në fakt, gjithmonë duke iu referuar shpjegimeve dhe kopjes së dokumentacionit zyrtar të dërguar nga ana juaj, këto akte zyrtare (të cilat rezultojnë që nuk janë akte administrative), janë të vetmet akte procedurale të nxjerra nga ana juaj për zhvillimin e procedurës administrative, për këtë çështje.

Efektivisht, na rezulton se kjo procedurë e zhvilluar nga ana juaj si organ publik ka filluar në datën 13.09.2022 dhe ka përfunduar në datën 02.11.2022.

Për më tepër, na rezulton se nga ana juaj, në shkelje të legjislacionit rregullator normues për veprimtarinë me objekt, respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit e burimeve ujore në të gjithë vendin, si dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, të decentralizimit dhe subsidiaritetit, në bazë të ndarjes administrative, nuk është nxjerrë asnjë akt administrativ individual, i nevojshëm, në bazë të cilit do të mund të justifikohet prishja e ndërtimit pa leje të zj. M.K..

Prishja e objektit të disponuar nga kjo shtetase, në kushtet e trajtimit të kësaj çështjeje, në kuptim dhe respektim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, do të mund të kryhej vetëm në bazë të një procedure administrative të zhvilluar në përputhje me ligjin dhe më e rëndësishmja, vetëm mbi bazën e ekzekutimit të një vendimi për prishje ndërtimi të kundërligjshëm, që duhej të nxirrej nga IMT-ja në Bashkinë Durrës. Deklarimi i vullnetit të organit tuaj publik, në ushtrim të funksionit shtetëror që kryen IMT-ja në Bashkinë Durrës, për arritjen e këtij qëllimi/ardhjen e kësaj pasaje, është një moment shumë thelbësor që mungon në trajtimin e kësaj çështjeje. Njoftimi i dërguar zj. M.K., për prishjen e objektit të disponuar prej saj, nuk është një akt administrativ. As Urdhri nr. 1813/3 prot., datë 13.09.2022 *“Për prishjen e objekteve të skualifikuara nga legalizimi, zona kadastrale 8517, Durrës”*, nuk rezulton të jetë një akt administrativ që në objektin e tij, të përkohë drejtëpërdrejtë me procedurën e nevojshme administrative që duhej të zhvillohej në këtë rast.

Shtojmë këtu edhe faktin tjetër se, “Procesverbal ekzekutimi”, nr. 1813/6 prot., datë 02.11.2022, nuk është hartuar dhe nxjerrë nga ana juaj në formatin e miratuar me VKM-në nr. 894/2015 (minimalisht këtij akti procedural i mungon numri serial).

Ndodhur në këto kushte, lind natyrshëm dhe logjikshëm pyetja se: Cilin vendim/akt administrativ ka ekzekutuar IMT-ja në Bashkinë Durrës, duke marrë në konsideratë dokumentin zyrtar “Procesverbal ekzekutimi”, nr. 1813/6 prot., datë 02.11.2022?²

Në një veprimtari administrative kaq të rëndësishme, e cila në thelbin e saj cenon të drejtën e pronës dhe të drejtën e strehimit, e për rrjedhim të drejtën për një jetë të qetë familjare e një game të drejtash të tjera shumë të rëndësishme të njeriut, është absolutisht e papranueshme dhe aspak ligjore fakti që mungon një vendimarrje në bazë të së cilës po kryhet kjo veprimtari.

Detyrë e vetme e IMT-së në Bashkinë Durrës, nuk mund të jetë thjesht prishja e objekteve në mënyrë mekanike, absolutisht jo, pasi ky është një organ publik dhe duhet ta ushtrojë veprimtarinë e tij administrative duke respektuar normat procedurale dhe në themel të kësaj veprimtarie duhet të jetë kujdesi për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Duket jashtë arsyes ligjore dhe logjike që të ndërmerret një veprim administrativ i cili, në thelb, të tij ka të bëjë me cenimin e të drejtave themelore të shtetasve dhe ai të mos dokumentohet. Theksojmë se çdo organ i administratës publike, përfshirë këtu edhe IMT-në në Bashkinë Durrës, në çdo veprim administrativ të kyer duhet të marrë masat e nevojshme për dokumentimin e veprimit, në kuadër të transparencës me palët

² Në pikën 1, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, thuhet se: *“Një akt administrativ fillon të sjellë pasojë juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve”*.

pjesëmarrëse në proces administrativ dhe të çdo të interesuari, si dhe në kuadër të llogaridhënies përkundrejt organeve kontrolluese. Gjithashtu, organi publik ka detyrimin të shprehet me një akt administrativ, mungesa e të cilit sjell cënimin e të drejtave të tjera, si e drejta për njohje me veprimtarinë administrative, me ushtrimin e ankimit, etj. Në raste të tjera analoge të trajtuara nga Avokati i Popullit, lidhur me veprimtarinë e inspektoriateve vendore të mbrojtjes së territorit gjatë procesit të prishjes së objekteve është konstatuar se ky organ publik ka marrë vendim në mënyrë nominale për çdo rast për prishjen e objekteve. Vetë legjislacioni ku mbështetet veprimtaria e inspektoriateve vendore të mbrojtjes së territorit parashikon nxjerrjen e vendimit të prishjes, si aktin administrativ i cili legjitimon ekzekutimin e kësaj veprimtarie administrative dhe iu jep të drejtë palëve të ushtrojnë të drejtën e ankimit. Kjo praktikë vërehet kryesisht në rastet kur konstatohen ndërtime të kundraligjshme dhe përbën bazën e veprimtarisë së inspektoriateve vendore të mbrojtjes së territorit, në mbrojtje të territorit.

Nga ana tjetër, qartas marrja e vendimit, apo vijimi i prishjes së objekteve para se të garantohen efektivisht lehtësirat që janë parashikuar nga ligji në fuqi, përbën cenim të së drejtës së pronësisë së qytetarëve, si dhe të drejtën për të pasur një proces të rregullt ligjor.

Thënë kjo pasi, pavarësisht shpjegimeve që na janë dhënë nga ana e Bashkisë Durrës, nuk del i qartë fakti nëse vendimmarrja e nevojshme në përputhje me legjislacionin rregullator të procesit të rindërtimit për këtë rast është e plotë, apo duhej të pasohej nga vendime të tjera të nevojshme, të cilat parashikohen nga ky legjislacion.

Duke iu referuar kohës gjatë së cilës është zhvilluar kjo procedurë administrative, është shumë vështirë të kuptohet, apo të provohet, nëse zj. M.K., ka marrë dijeni për shkresën tuaj nr. 1814 prot., datë 13.09.2022, me të cilën njoftoni këtë shtetase për prishjen e objektit të disponuar prej saj. Pra, nuk arrihet të provohet se cila ka qenë mënyra e njoftimit e kryer nga ana juaj, në zbatim të parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative. Barra e proves në këtë rast i takon organit përkatës publik.

Kjo mënyrë njoftimi mbetet e paprovuar dhe për pasojë rezulton se ankueses i është prishur banesa e saj pa pasur mundësinë e përgatitjes së ankimit, si dhe mbrojtjes në gjykatë, si një prej të drejtave ekzistenciale në një shoqëri demokratike.

Çdo organ i administratës publike kur procedon me njoftimin e një akti, apo veprimi administrativ të tij duhet të mbajë parasysh faktin dhe të kujdeset që njoftimi të jetë efektiv, t'i sigurojë mbrojtje ligjore palës, të jetë i kuptueshëm dhe i arsyetuar, të bëhet duke pasur parasysh koston sa më të ulët për ta kryer.

Konkretisht, Kodi i Procedurave Administrative, në pikën 1 dhe 3, të nenit 147, të tij parashikon:

"1. Organi publik i komunikon palës ose një subjekti tjetër, të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural me anë të njoftimit.

3.Në çdo rast, organi publik kryen njoftimin, duke pasur parasysh efektivitetin e tij, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën dhe koston".

Nga informacioni zyrtar i dërguar na rezulton se njoftimi është hartuar nga ju si organ publik, por nuk na keni dërguar asnjë informacion si ia keni komunikuar subjektit që të

provohet se është dërguar, pasi nuk ka asnjë provë të dokumentuar, apo fakt tjetër (megjithëse ky shpjegim është kërkuar paraprakisht nga ana jonë), që të provojë se njoftimi është dërguar dhe se ankuesja e ka marrë atë, duke u njohur me të në mënyrë nominale. Në këtë rast vlerësohet se njoftimi nuk është dërguar dhe zj. M.K., nuk është njohur me të, duke qenë se barra e provës bie mbi ju si organ publik, që të provoni njoftimin rregullisht dhe në zbatim të normave procedurale. Për rrjedhojë, ankueses nuk i është lënë një afat i arsyeshëm për marrjen e masave për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm, dhe më tej nuk ka pasur as afatin për të ushtruar të drejtën e ankimit, si një e drejtë mjaft e rëndësishme në respektimin e çdo procedure ligjore administrative. Gjithë sa parashtruar më lart, të shpie në përfundimin se IMT-ja në Bashkinë Durrës, ka kryer veprimtari të parregullt dhe të paligjshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij administrative. Shkelja e rregullave dhe procedurave të njoftimeve në vetevete përbën cënim të parimit të procesit të rregullt ligjor, si një prej parimeve që qëndron në themel të procedurave ligjore e administrative.

Me fjalë të tjera, shteti duhet të garantojë mbrojtje ligjore kundër dëbimeve të detyruara, ngacmimeve, të ofrojë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për sigurimin e banesës dhe një strehim të përshtatshëm. Siguria e banesës nuk përmbledhet në një nocion të vetëm, por ajo paraqitet në harmoni me të drejtat e tjera si drejta e pronësisë, e përdorimit, aksesit në gjykatë, procedurave të rishikimit administrativ e gjyqësor, etj. Për sa parashtruar evidentohet qartësisht se IMT-ja në Bashkinë Durrës, në këtë procedurë dhe formë sjelljeje të tij ka cënuar të drejtën e banesës dhe atë të jetës private, renditur këto si ndër të drejtat më të rëndësishme të njeriut.

Në vijim të parashtrimit të shkeljeve dhe cenimit të të drejtave dhe parimeve themelore, konstatohet se një prej të drejtave më të rëndësishme të cënuara gjatë këtij procesi administrativ, sikurse edhe u parashtrua, është edhe e drejta e ankimit dhe ajo e aksesit në gjykatë. Këto të drejta janë cënuar në thelbin e tyre nga IMT-ja në Bashkinë Durrës, si rrjedhojë e mosrespektimit të normave materiale e procedurale. Mosrespektimi i normave procedurale gjatë procesit të njoftimit për prishjen e objekteve ka sjellë për pasojë mospasjen e kohës së mjaftueshme për tu ankuar ndaj vendimeve të tij dhe për t'iu drejtuar gjykatës kompetente.

Kujtojmë këtu se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në praktikën e saj por edhe normat ndërkombëtare e kanë përfshirë të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, apo aksesin në gjykatë, si pjesë të procesit të rregullt ligjor. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (*KEDNj*), e ka sanksionuar këtë të drejtë, si një ndër të drejtat themelore të njeriut, duke parashikuar në nenin 13, se: *"Çdo person të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura nga kjo konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare edhe atëherë kur kjo shkelje është kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare"*.

E drejta për ankim efektiv është një e drejtë themelore e njeriut dhe nënkupton të drejtën e individit për ankim, ekzistencën e një organi të caktuar për shqyrtimin e ankimit, pranimin e pakushtëzuar të ankimit për shqyrtim, afate të arsyeshme për shqyrtimin e tij. Në vetvete ky nen sanksionon jo vetëm të drejtën e individit për t'u ankuar, por dhe detyrimin e shtetit për t'i garantuar atij këtë të drejtë. Në një sërë çështjes kundër Shqipërisë, (Qufaj kundër Shqipërisë, Sharxhi kundër Shqipërisë etj), ndër të tjera nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (*GJEDNj*) theksohet se, sistemi ligjor shqiptar ofron mjete juridike të brendshme, për të ankimuar një shkelje të së drejtës për një proces

të rregullt ligjor dhe këto mjete duhet të jenë efektive dhe të garantohen nga organet përkatëse. Në funksion të garantimit dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave, legjislacioni shqiptar ka sanksionuar normat ligjore efektive. Konkretisht, në rast se i referohemi pikërisht ligjit organik të mbi të cilin e mbështet veprimtarinë e tij IMT, konstatohet se ligji nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, në nenin 14 të tij, parashikon se: *"Kundër vendimit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore lejohet ankimi i drejtëpërdrejtë në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit"*. Kjo dispozitë shkon në të njëjtën logjikë me respektimin e së drejtës së ankueses për tu ankuar dhe për t'iu drejtuar gjykatës. Madje në funksion edhe të arsytimit të paragrafëve të mësipërm, sanksionohet edhe fakti që ky organ publik duhet të dalë me vendim për prishjen e objekteve dhe njoftimi duhet të jetë mjeti efektiv mbrojtës i të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve. Vetë legjislatori ka parshikuar një afat prej 10 ditësh për tu njohur me aktin dhe për përgatitur mbrojtjen/ankimin, duke mos e konceptuar ushtrimin e një të drejte jashtë konceptit kohë e mjaftueshme.

IMT-ja në Bashkinë Durrës, duket se gjithë këtë veprimtari e ka justifikuar me mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave publikë, për zhvillimin e zonës së re për strehimin e banorëve të prekur nga tërmeti dhe kategoritë e tjera të parashikuara në ligj. Por shmangia nga kompetenca ligjore prej organeve publike nuk mund të justifikohet me këtë arsyetim, sidomos në kushtet e një gjendjeje të zakonshme. Organet e administratës shtetërore gjatë veprimtarisë së tyre duhet të ruajnë ekuilibrin ndërmjet të drejtave dhe interesave shtetërore, apo publike dhe atyre individuale. Në asnjë rast nuk mund të cënohen të drejtat dhe interesat e qytetarëve pa respektuar parimin e proporcionalitetit ndërmjet këtyre të drejtave, si dhe atë të procesit të rregullt ligjor. Shteti shqiptar, si subjekt i legjitimuar në GjEDNJ, ka qenë ndër vite në epiqendër të kësaj gjykate, pikërisht për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ku më evidente ka qenë e drejta për një proces të rregullt ligjor. Duhet theksuar gjithashtu se, shteti shqiptar dhe taksapaguesit e tij mbajnë mbi supe detyrime dhe fatura financiare që vijnë si rezultat i vendimeve të GjEDNJ-së, ku shteti shqiptar është dënuar për mosrespektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Mënyra e trajtimit të kësaj çështjeje nga IMT-ja në Bashkinë Durrës, konstaton faktin se ankueses i është përkeqësuar situata konkrete ligjore duke iu shkelur e drejta themelore për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në paragrafin e parë të nenit 42, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 6 dhe 13, të KEDNJ-së.

Për më tepër, kjo mënyrë trajtimi e çështjes nga ana e organit tuaj publik, evidenton shkelje të parimit të ligjshmërisë, parimit të procesit të rregullt ligjor, parimit të transparencës dhe informimit, parimit të dhënies së ndihmës aktive, parimit të përgjegjësisë si dhe parimit të marrjes së vendimeve,³ parime shumë të rëndësishme këto që duhet të respektohen përgjatë gjithë veprimtarisë së organeve publike.

E vlerësuar në një këndvështrim më të gjerë veprimtaria juaj në kushtet e cilësuar në këtë rekomandim përbën premisa për cënimin e parimit të sigurisë juridike, pasi ky parim presupozon në thelb, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti. Kjo siguri duhet të jepet nga ana e shtetit jo vetëm në pandryshueshmërinë e legjislacionit për marrëdhëniet e rregulluara, por edhe në garantimin e ligjshmërisë së veprimeve që shteti kryen me

³ Këto parime parashikohen shprehimisht, përkatësisht, në nenet 4, 5, 6, 10, 15 dhe 16, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

qytetarët e tij, në marrëdhëniet juridike që ai krijon me ta, duke patur gjithmonë në fokus respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të ligjshme, të njeriut.

Ky vlerësim analitik bazohet në parimin kushtetues se, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut është jo vetëm një e drejtë e individit por edhe detyrim parësor kushtetues në veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore.

Fryma dhe logjika e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar, në përcaktimin e kompetencave dhe afateve procedurale, për konstatimin e ndërtimit të kundërligjshëm, nxjerrjen e vendimit përkatës penalizues për kundërvajtësin, njoftimin e këtij vendimi dhe ekzekutimin e tij, është e tillë që shkon në të njëjtën linjë përputhshmërie me respektimin e së drejtës themelore të individit, për një proces të rregullt ligjor në rrafshin administrativ të shqyrtimit të çështjes, por edhe të të drejtave të tjera të ligjshme të garantuara nga legjislacioni në fuqi.

Në këtë çështje vërehet se, IMT-ja në Bashkinë Durrës, nuk arrin të dokumentojë dhe vërtetojë zhvillimin e një procedure normale administrative, për prishjen e objektit të poseduar nga zj. M.K..

Ky është rasti kur kemi të bëjmë me një ndërtim të kundërligjshëm të cilësuar si të tillë nga vendimmarrja paraprake e DVASHK-së Durrës, por IMT-ja në Bashkinë Durrës, ka dështuar në kryerjen dhe zhvillimin normal, në përputhje me legjislacionin në fuqi të procedurës administrative që ka si qëllim fundor prishjen e këtij ndërtimi, sipas fazave procedurale të nevojshme për konstatimin, sanksionimin me vendimmarrjen përkatëse të ndërtimit të kundërligjshëm dhe njoftimit të akteve të dala subjektit kundërvajtës, për të vazhduar me ekzekutimin e kësaj vendimmarrjeje.

Në këtë kontekst është me vend të sjellim në vëmendjen tuaj, parimin e përgjegjësisë në veprimtarinë e organeve publike të parashikuar në nenin 15, të Kodit të Procedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

“Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Sipas parashikimeve të ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, të ndryshuar (ligji nr. 8510/1999), trajtimi i kësaj çështjeje në kushtet e analizuara në këtë rekomandim, i ka shkaktuar një dëm real jashtëkontraktor zj. M.K..

Kuptimi i garantimit të përgjegjësisë së organeve të administratës shtetërore për çështje që janë nën kontrollin e tyre, lidhet ngushtë me parimin e përgjegjësisë administrative, parim ky që përbën një nga bazat e shtetit të së drejtës dhe të funksionimit të një administratës publike demokratike. Organet e administratës shtetërore janë përgjegjëse për veprimet, ose mosveprimet e tyre në ushtrimin e funksioneve, që janë në kompetencën e tyre ligjore.

Nëse organet publike, pjesë e organeve të administratës shtetërore ku përfshihet edhe IMT-ja në Bashkinë Durrës, marrin vendime të paligjshme, tejkalojnë kompetencat,

veprojnë në mënyrë të gabuar, apo neglizhojnë detyrimet e tyre, atëherë duhet të mbajnë përgjegjësi ligjore për pasojat që shkaktojnë.

Në thelb, përgjegjësia jashtëkontraktore është një nga mënyrat konkrete me anë të të cilës realizohet garantimi i përgjegjësisë së organeve shtetërore ndaj qytetarëve.

Inspektoriati vendor i mbrojtjes së territorit është i detyruar të zbatojë procedurat ligjore, përfshirë nxjerrjen e vendimit përkatës, para se të ndërmarrë veprime për prishjen e objekteve, përfshirë këtu ndërtimet e kundërligjshme. Prishja e ndërtimit pa vendim të nxjerrë për këtë qëllim nga ana e këtij organi publik është në thelb veprim arbitrar dhe një veprim i kryer tej kompetencave të tij ligjore

Edhe pse ndërtimi është i paligjshëm dhe duhet prishur, procedura për prishjen e tij duhet të jetë e rregullt, gjë që do të thotë se duhet të ketë një vendim administrativ që e parashikon dhe vendos këtë veprim të organit publik kompetent. Mungesa e vendimit nuk e bën veprimin në këtë rast të justifikueshëm ligjërisht, edhe pse qëllimi (prishja e ndërtimit të paligjshëm) që kërkon të arrijë organi publik është i drejtë. Në këtë rast, veprimi pa një vendim për prishje konsiderohet si shkelje e ligjit nga organi publik. Nëse personi i dëmtuar nga prishja e ndërtesës nuk ka patur mundësi të parashtojë pretendime ose ankesa, ose nëse veprimi i organit përkatës publik i ka shkaktuar dëm, atëherë këtij organi publik i lind përgjegjësia për kompensim. Pra, organi mund të jetë i përgjegjshëm jashtëkontraktualisht për dëmin e shkaktuar, për shkak të veprimit të paligjshëm (në mungesë të nxjerrjes së një vendimi për këtë qëllim).

Përgjegjësia nuk ndalet me faktin që ndërtimi është i paligjshëm, sepse veprimi që duhet të ndërmerret nga organi publik kompetent për prishjen e tij, duhet në çdo rast të respektojë procedurat ligjore. Veprimi i prishjes së një objekti/ndërtimi pa vendim, në këto kushte është i paligjshëm dhe organi publik që ka kryer këtë veprim është përgjegjës jashtëkontraktualisht për dëmin e shkaktuar. Personi i dëmtuar ka të drejtë të kërkojë kompensim për dëmin që i është shkaktuar nga veprimi i organit publik, në këto rrethana.

Në këtë analizë duam të sjellim në vëmendje nenin 9, të ligjit nr. 8510/1999 në të cilin parashikohet se:

“Organi i administratës shtetërore nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij, në qoftë se dëmi nuk do të mund të shmangej edhe nëse do të ishte treguar kujdesi i duhur gjatë ushtrimit të funksioneve shtetërore, në pajtim me rrethanat.

Përgjashtimi i mësipërm nuk zbatohet në rastin e mosfunksionimit të mjeteve teknike”.

Në fakt, kjo dispozitë ligjore parashikon se përgjegjësia për dëmin është e kufizuar dhe se ekziston një parashikim ligjor për **përgjashtimin e organit të administratës shtetërore nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar një subjekti të caktuar. Pra, organet përkatëse të administratës shtetërore** nuk mbajnë përgjegjësi për çdo dëm që ato shkaktojnë gjatë veprimtarisë së tyre, me veprimet ose mosveprimet përkatëse. **Ky rast i referohet standardit juridik të ekzistencës së "forcës madhore" ose "rrethanave përjashtuese", që e përjashton përgjegjësinë në rastet kur dëmi është i pashmangshëm.**

Megjithatë, vetë dispozita parashikon se kjo mungesë përgjegjësie është e kushtëzuar nga disa kritere, sipas të cilave:

- nuk ka faj të qëllimshëm, apo neglizhencë,
- është treguar kujdesi i duhur sipas standardeve profesionale dhe ligjore,
- dëmi ka ndodhur për shkaqe të jashtme, apo të pashmangshme.

Për sa më sipër dhe eventualisht, veprimi i kryer nga ana e IMT-së në Bashkinë Durrës, për prishjen e banesës së ankueses, nuk është në kushtet e parashikuara nga neni 9, i ligjit nr. 8510/1999, por përbën veprim në kushtet e shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor.

Prishja e pronës në posedim pa një vendim administrativ përkatës, pa i dhënë të drejtën familjes së ankueses dhe pa i garantuar as “prima face”, dhe as efektivisht të drejtën e strehimit kësaj familjeje është veprim i paligjshëm, edhe nëse ndërtimi është i paligjshëm. Organi është përgjegjës jashtëkontraktualisht për dëmin e shkaktuar. Respektimi i procedurës administrative është kusht i domosdoshëm për ligjshmërinë e veprimeve të organeve publike, rast pas rasti.

Në kuptimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore, si një detyrim i organeve të administratës shtetërore, për të shpërblyer dëmin që i është shkaktuar interesave të ankuesit si person privat, në ushtrim të sipër të funksioneve tuaja publike, rasti në fjalë parashikohet në nenin 3/a, të nr. 8510/1999, ku parashikohet se:

“Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë private, në rastet që vijojnë:

- *Kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme”.*

Mbi këtë bazë dhe në përputhje me parashikimet e neneve 6, 8 dhe nenin 17, pika 2, të ligjit të sipërcituar, IMT-ja në Bashkinë Durrës, duhet që të fillojë një procedim administrativ për njohjen e dëmit që i ka shkaktuar zj. Kulicaj në këtë rast, duke marrë për bazë edhe dispozitat respektive të Kodit Civil, për shkaktimin e dëmit.

Duke u ndalur specifikisht në nenin 17, pika 2, të ligjit nr. 8510/1999,⁴ sjellim në vëmendjen tuaj faktin se analiza e kryer në këtë rekomandim për ligjshmërinë e veprimeve të ndërmarra nga ana e IMT-së në Bashkinë Durrës, për prishjen e pronës në posedim të familjes së ankueses, përbën për ankuesen, marrje dijeni për rrethanat, të cilat e kanë bërë situatën të kundërligjshme.

Në këtë rast kemi të bëjmë me konceptin e “marrjes dijeni për rrethanat që e kanë bërë situatën të kundërligjshme”, dhe në këto kushte afati parashkrues për kërkimin e dëmit jashtëkontraktor nuk fillon në momentin kur personi që pësuar dëmin ka marrë dijeni për dëmin (data e prishjes së ndërtimit) dhe organin që e ka shkaktuar atë, por në momentin kur ai ka mundur të kuptojë faktet dhe rrethanat që e bëjnë situatën e shkaktimit të dëmit të kundërligjshme. Mjafton që i dëmtuari të ketë dijeni për rrethanat që e cilësojnë veprimin ose gjendjen **të kundërligjshme**, ndryshimet që kanë sjellë pasojën e dëmshme dhe faktet thelbësore që vërtetojnë kundërligjshmërinë.

⁴ Në nenin 17, pika 2, të ligjit nr. 8510/1999, parashikohet se:

“Në rastin kur dëmi shkaktohet nga ndryshimi i situatës, në vend të marrjes dijeni për dëmin, futet koncepti i marrjes dijeni për rrethanat, të cilat e kanë bërë situatën të kundërligjshme”.

Afati procedural për kërkimin e dëmit jashtëkontraktor në këtë çështje, fillon në momentin kur poseduesi i ndërtimit pa leje, të prishur nga ana e IMT-së në Bashkinë Durrës, pa një procedurë të rregullt ligjore dhe pa një vendim përkatës, ka marrë dijeni për **rrethanat që e cilësojnë veprimtarinë e prishjes së këtij ndërtimi, si të kundërligjshme**.

Pra, prishja e një ndërtimi pa leje, si një veprimtari administrative e kryer nga ana e IMT-së në Bashkinë Durrës, në mungesë të një vendimi për prishje dhe pa respektuar procedurat e domosdoshme ligjore, është shembull tipik i një situate ku dëmi shkaktohet nga ndryshimi i situatës dhe ku afati i parashkrimit për kërkimin e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar, lidhet me momentin kur personi merr dijeni për rrethanat e kundërligjshme në të cilat është kryer prishja e objektit të tij, në posedim.

Në këtë rast, dëmi faktik është ditur nga zj. M.K., që në momentin e ndërhyrjes për prishjen e ndërtimit të saj pa leje, nga ana e IMT-së në Bashkinë Durrës, por kundërligjshmëria e veprimit të organit tuaj publik **nuk ishte objektivisht e njohshme** nga ana e saj, pa ditur faktin e **mungesës së aktit administrativ**/vendimit për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm. Vetëm marrja dijeni për këtë rrethanë nga ana e ankueses, rrethanë kjo e analizuar gjerësisht dhe e konstatuar specifikisht në këtë rekomandim, aktivizon afatin procedural ligjor në përputhje me nenin 17, pika 2, të ligjit nr. 8510/1999.

Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në përputhje me nenin 18, të ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar, ku parashikohet respektivisht se:

“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit...,

paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

“Procedurat për kërkimin dhe përmbushjen e dëmshpërblimit bëhen në përputhje me kërkesat e ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

R E K O M A N D O J M Ë

Për Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Durrës:

1. Fillimin e procedurës administrative për shpërblimin e dëmit, që i është shkaktuar shtetases zj. M.K., si pasojë e ndërhyrjes nga ana juaj për prishjen e banesës së saj, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, dhe specifikisht me parashikimet e

ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, të ndryshuar, pa një proces të rregullt ligjor dhe pa respektuar dispozitat procedurale në këtë rast

2. Marrjen e masave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Durrës, për nxjerrjen e përgjegjëseve dhe evidentimin e personave përgjegjës që kanë çuar në shkeljen strukturore të të drejtave dhe interesave të ligjshëm të zj. M.K., të drejta këto të cenuara nga prishja pa një proces të rregullt ligjor të banesës së saj.
3. Marrjen e masave administrative për mospërsëritjen në vijim të situatave të tilla të ndërhyrjes ndaj objekteve private pa respektuar procedurat ligjore dhe të drejtat e shtetasve pronarë të ligjshëm, apo posedues të tyre.

Për Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit:

1. Përgjithësimin e rastit dhe marrjen e masave për garantimin e zbatimit të detyrimeve ligjore nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit në nivel Kombëtar, në kuadër të prishjes së ndërtimeve pa leje.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Erinda MELI

d.v